



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3804 Prot.

Roskovec, më 30, 07 2020

VENDIM

NR 53. DATË 28.07. 2020

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN QERSHOR 2020”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.06.2020, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Qershor 2020.
- 2- Ngarkohet Sekretaria e Këshillit Bashkiak me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 308/Prot.

Roskovec, më 01.07.2020

Procesverbal Nr.6

-I mbajtur sot, date 29.06.2020, ora 11, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes. Kjo mbledhje po zhvillohet ne sallen e madhe te Pallatit te Kultures, e cila siguron uljen e keshilltareve larg nga njeri-tjetri duke ruajtur ne kete menyre distancimin fizik, ne perputhje me vendimet e qeverise. Rendi i dites :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Maj 2020.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Maj 2020.
5. Për miratimin e Rregullores “Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare”.
6. Për disa ndryshime në Vendimin Nr.105 datë 22.11.2019 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2020”.
7. Për një ndryshim në Vendimin Nr.37 datë 29.05.2020 “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Tregut Publik në Bashkinë Roskovec”.
8. Anulim të Vendimit Nr.24 datë 27.04.2020 “Për dhënie ndihma ushqimore për familjet në nevojë për shkak të epidemisë nga Covid-19”.
9. Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin Nr.116 datë 20.12.2019 “Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec, për vitin 2020”.
10. Për miratim dhe transferim fondesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2020.
11. Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Roskovec.
12. Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Strum, Bashkia Roskovec.
13. Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Kuman, Bashkia Roskovec.
14. Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore dhe të pronave, pyje dhe kullota, që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Kurjan, Bashkia Roskovec.

15. Informacion mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore për periudhën e raportimit në territorin e Bashkisë Roskovec gjatë pandemisë Covid-19.
16. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 11⁰⁰

Keshilltaret prezantues: A.Kola, V.Mata, L.Goga, B.Kuka, K.Hyska, A.Hazizi, V.Bakaj, V.Dogani, A.Shem e, V.Stani, H.Beqiraj, B.Toska, M.Sufka.

Keshilltaret

qe

mungojne

: K.Kuka, E.Çepele, Rr.Hazizi, L.Hoxha, B.Çobo, T.Kuka, D.Hoxha, G.Hoxha.

Te pranishem nga administrata e bashkise: Nenkryetari M.Goga, Sekretarja e Pergjithshme, Dr.Juridike, Dr.Finances, Sp.Urbanistikes, P/Z/Tatim-Taksave, P/Z/Ndihmes Ekonomike, Kordinator e dhunes ne familje.

Me plotesimin e kuorumit, kryetari i keshillit hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 13 keshilltare.

Kryetari ben me dije se sot mbledhja do te jepet live ne facebookun e bashkise, kjo ne bashkepunim me projektin "Bashki te Forta" te cilet po na asistojne ditën e sotme me perfaqesuesit e tyre. Para se te filloj me rendin e dites, Kryetari ben me dije se kemi disa projekte dhe materiale shtese nga administrata e bashkise te cilat do ti hedhim ne votim per ti futur ne rendin e dites, si me poshte: "Per disa ndryshime ne VKB Nr.27 date 27.04.2020 "Per shitjen e pronave te paluajtshme ne pronesi te Bashkise Roskovec per familjet qe kane mbetur te pastreha per shkak te investimit per interes publik dhe perjashtimit nga procesi i legalizimit", ne projekt-vendimin e pikes Nr.10 te rendit te dites "Per miratim dhe transferim fondesh ne buxhetin e Bashkise Roskovec per vitin 2020" shtohet edhe nje pike "miratim i fondit perkates per objektin "Memoriali tek Blloku Nr.2, Roskovec", si dhe prezantimi i raportit te performances i buxhetit te Bashkise Roskovec per 2019. I hedh ne votim per ti futur shtese ne rendin e dites dhe miratohen unanimisht me 13 vota pro per ti futur ne rend dite. Sqaron se raportin e performances do ta prezantojme ne fillim te rendit te dites.

1. Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

E hedh ne votim rendin e dites me gjithë shtesat e bera si me siper dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

2. Raporti i performances i Buxhetit te Bashkise Roskovec per vitin 2019.

Nenkryetari Leksi Goga sqaron me pak fjale se ku konsiston raporti i performances, i cili do te prezantohet me video projektor nga drejtori i finances. Ky raport eshte pergatitur ne bashkepunim te bashkise me projektin "Bashki te Forta". Leksi lexon shkresen ku sqaron raportin e performances se bashkise. I kalon fjalen Drejtorit te Finances Selmanit per prezantimin e raportit te performances. Selmani ngrihet dhe fillon sqarimin me detaje te raportit te performances, sqaron si eshte planifikuar dhe sa jane shpenzuar, nga kane ardhur leket duke I sqaruar sipas zerave konkret. 54% e zene te ardhurat nga taksat lokale. Per vitin 2019 kemi shpenzuar -2% me pak se nje vit me pare. Vendin kryesor te shpenzimit e ze kujdesi social. Raporti na ndihmon te kuptojme shifrat, permban te dhena financiare dhe teknike qe lidh parate e shpenzuara me rezultatet. Prioritet kane qene kujdesi social, furnizimi me uje, arsimi baze etj. Eshte shpenzuar 11.3% e buxhetit te administrates se bashkise. Dr.Finances sqaron me detaje pikat kryesore te raportit dhe sa % eshte shpenzuar sipas zerave perkates. I kemi realizuar ne masen e duhur te gjitha detyrat dhe funksionet e planifikuar. Viktori-e degjova me vemendje drejtorin e finances, te ardhurat qe vilni nga taksat vendore ti specifikonit se nga vijne keto te ardhura, jo ne menyre te pergjithshme por te

specifikohet se nga vijne.Leksi-shifra per pastrimin e kanaleve dhe ujitjes mu duk pak shifer e larte,fiktive.Dr.finances sqaron Viktorin,e mira do ishte ti benim me fshatra dhe lagje,por ky raport e tregon ne menyre te permbledhur,analizen me te detajuar do ta keni ne fazen e hartimit te buxhetit.Nenkryetari M.Goga falenderon projektin “Bashki te Forta” dhe administraten e bashkise ne lidhje me transparencen e bashkise para komunitetit.Falenderon edhe per pjesmarrjen ne degjesat publike te keshilltareve,dhe thekson se do jemi gjithmone transparent ndaj kmunitetit.

3.Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Maj 2020.

Sekretarja e keshillit sqaron vendimet e marra mbledhjen e kaluar.Sqaron se nga vendimet e marra,vetem 2 vendime ishin me karakter normative.Keto jane derguar ne Prefektore dhe jane konfirmuar

4.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Sekretarja e keshillit sqaron se procesverbali eshte zbardhur dhe eshte punuar elektronikisht.Hidhet ne votim procesverbali dhe miratohet unanimitisht me 13 vota pro.

5.Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Maj 2020.

P/Z/NE Elis Apostoli sqaron projektin e 6% sipas familjeve perkatese qe jane perfituese.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimitisht me 13 vota pro fondi 6%.

6.Per miratimin e Rregullores “Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave,verejtjeve,kerkesave,peticioneve dhe iniciativave qytetare”

Sqarohet se jane bere degjesa publike sipas afateve ligjore.Dr.Juridike sqaron me pak fjale se cfare permban kjo rregullore.Leksi-e kemi lexuar rregulloren,kjo i perket edhe qytetareve sesi ata duhet te veprojne,e kane pasur te drejten e tyre te mernin pjese ne degjesen publike ku te thonin mendimin e tyre.Hidhet ne votim rregullorja “Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave,verejtjeve,kerkesave,peticioneve dhe iniciativave qytetare” dhe miratohet unanimitisht me 13 vota pro.

7.Per disa ndryshime ne Vendimin Nr.105 date 22.11.2019 “Per miratimin e Paketes Fiskale per vitin 2020”

P/Z/tatim-taksave sqaron projektin e ndryshimeve ne Paketën Fiskale.Ditmira Goga sqaron edhe ndryshimin ne tarifen e tregut publik e cila ishte 50 leke/m2 dhe propozohet te behet 35 leke m2 duke u nisur dhe nga takimet qe ne kemi bere me biznesin.Nenkryetari M.Goga sqaron se ne kemi marr te gjitha masat per disiplinimin e tregut,kemi propozuar uljen me 30% te tarifes se tregut.Eshte disiplinuar tregu pervec shitjes se peshkut.Leksi-sistemimi i tregut ishte nje pune shume e veshtire,falenderoj administraten per punen e bere dhe per reagimin e shpejte te uljes se tarifes ne dobi te komunitetit.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimitisht me 13 vota pro ndryshimet ne Paketën Fiskale per vitin 2020 sipas meterjalit te paraqitur.

8.Per nje ndryshim ne Vendimin Nr.37 date 29.05.2020 “per miratimin e Rregullores per Funkcionimin e Tregut Publik ne Bashkine Roskovec”.

Aleksander-nuk jam dakort per shtimin e pikes “d” sekuestrim i mallit,them se jane te mjaftueshme pikat e tjera.Nenkryetari sqaron se nuk kemi zbatuar asnje nga ato pika,por eshte detyrim ligjor te miratohet ne keshill,jemi te detyruar te shkojme deri ne ate pike nese do na detyrojne,por ne asnje menyre nuk duam te arrijme atje.Dr.juridike sqaron ndryshimin.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimitisht me 13 vota pro ndryshimi ne rregulloren per funksionimin e tregut publik.

9.Anulim te Vendimit Nr.24 date 27.04.2020 “Per dhenie ndihma ushqimore per familjet ne nevoje per shkak te epidemise nga Covid-19”

Nenkryetari M.Goga sqaron arsyen perse po anulohet ky vendim,me fondet e miratuara mbuluan muajin Prill dhe fazen e dyte te ndihmave ne bashkepunim edhe me donatoret.Leksi-ai fond i perballoi te gjitha nevojat?M.Goga sqaron se ky fond nuk ishte i nevojshem dhe duhet te kaloje ne destinacion tjeter.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

10.Per miratimin e ndryshimeve ne Vendimin Nr.116 date 20.12.2019 "Per miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal te punonjesve te Bashkise Roskovec per vitin 2020"

Dr.Juridike Delina Hoxha sqaron ndryshimin,shtohet 1 punonjes i cili do te jete ne pozicionin e"keshilltarit te kryetarit" per te ndjekur ceshtje te caktuara.Leksi-pyet do jete vetem thjesht keshilltar i kryetares?nuk jam kundra ler te shtohet,por kemi kaluar per taksat dhe tatimet nje drejtues pse nuk plotesohet sepse eshte vertete zyre me rendesi dhe duhet te jete me serioze.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

11.Per miratim dhe transferim fondesh ne Buxhetin e Bashkise Roskovec per vitin 2020.

Dr.Finances sqaron se ky eshte me teper nje saktetim i vendimeve te meparshme.Sqaron zerat e parashikuar sipas materjalit qe kane te gjitha keshilltaret.Sqaron edhe piken shtese qe u fut sot ne lidhje me objektin "Memoriali tek Blloku Nr.2,Roskovec".Kontributi i bashkise eshte i njejte si ne fillim,vetem i ndare me vite financimi.Ky eshte bashkefinansim i bashkise me kontribut te komunitetit.Blerja e skrepit dhe blerje materialesh jane te miratuara ne buxhet,po behet rifreskimi i tyre-sqaron M.Goga.Leksi-kemi qene pro investimeve,theksojme se duhet te shihet edhe cilesia,me kaq leke mund te blejme nje skrep cilesor,dakort jemi edhe per mobilimin e sallave.Vjollca-per uren e fshatit Cerven eshte shume e domosdoshme per keta banore dhe kerkoje mirekuptimin tuaj ta kalojme ne votim.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro sipas materjalit te paraqitur.

12.Per perditesimin e listes se inventarit te pronave te paluajtshme shteterore qe ndodhen ne territorin e Bashkise Roskovec.

Sp.Urbanistikes Irena Kola sqaron projektin e perditesimit te listave te inventarit te pronave te paluajtshme shteterore ne territorine e Bashkise Roskovec.Eshte e nevojshme te behet perditesimi i ketyre listave te cilat jane shtuar apo ndryshuar.Eshte ngritur nje grup pune,eshte bere edhe evidentimi ne fakt i ketyre pronave.Viktori-sa eshte siperfaqja totale e ketyre pronave?Specialistja sqaron se nuk jepet siperfaqja totale ne pergjithesi por e ndare per cdo prone qe ndodhet ne Bashkine Roskovec.Viktori-kerkon konkretisht per njesine Kuman sesa eshte siperfaqja e pronave.Kryetari i keshillit i le detyre specialistes se urbanistikes per ta sqaruar ne mbledhjen e ardhshme.Viktori-keto prona a ndodhen te lira sot?apo jane te zaptuara?Kryetari sqaron se mund te kete edhe prona te zaptuara,por do te ndiqen procedurat e caktuara ligjore.Keto inventare do te kalojne edhe ne Keshillin e Ministrave.Viktori-kerkoj heren tjeter te vij lista e tokave are qe eshte e paregjistruar,qofte dhe e zaptuar ne Marinze dhe e diskutojme prape.Leksi-te kishim nje liste,qofte edhe komisionit perkates.Alketi-ka disa prona qe tjeter jane ne AMTP dhe tjeter jane te regjistruara,ka toke shtet qe e kane kthyer ne private,keto si verifikohen?Kryetari-nuk ben pjese ne kete pike te rendit te dites.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro perfitesimi i listes se inventarit te pronave te paluajtshme shteterore ne territorin e Bashkise Roskovec.

13.Per perditesimin e listes se inventarit te pronave te paluajtshme shteterore qe ndodhen ne territorin e Njesise Administrative Strum,Bashkia Roskovec.

Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro perditesimi i listes se inventarit te pronave te paluajtshme shteterore qe ndodhen ne Njesine Administrative Strum.

14. Per perditesimin e listes se inventarit te pronave te paluajtshme shteterore qe ndodhen ne territorin e Njesise Administrative Kuman, Bashkia Roskovec.

Viktori-kerkon informacion per listen e tokave are te paregjistruar/zaptuar ne Marinez. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro perditesimi i listes se inventarit te pronave te paluajtshme shteterore ne Njesine Administrative Kuman.

15. Per perditesimin e listes se inventarit te pronave te paluajtshme shteterore dhe te pronave, pyje dhe kullota, qe ndodhen ne territorin e Njesise Administrative Kurjan, Bashkia Roskovec.

Nuk ka pyetje. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro perditesimi i listes se inventarit te pronave te paluajtshme shteterore dhe pronave pyje dhe kullota ne territorin e Njesise Administrative Kurjan.

16. Informacion mbi situaten e dhunes ne familje dhe dhunes me baze gjinore per periudhen e raportimit ne territorin e Bashkise Roskovec gjate pandemise Covid-19.

Borana Kuka-kryetare e komisionit te barazise gjinore sqaron se kjo eshte e bere nga ne si komision, falenderon edhe punonjesen per pergjigjen e kthyer ne nje kohe te shkurter. Nertila Pelivani sqaron informacionin e rasteve te trajtuara te dhunes ne familje sipas metarjalit shperndare keshillit. Leksi-eshte bere nje pune per tu pershendetur, sidomos ne kohen e pandemise, materjali eshte shume plotesues. Eshte bere nje pune shume e mire. Nertila-gjate pandemise ne kemi perdorur rrjetet sociale sepse kemi qene koshient qe ishte rrezik per rastet e dhunes ne familje.

17. Per disa ndryshime ne VKB Nr.27 date 27.04.2020 "Per shitjen e pronave te paluajtshme ne pronesi te Bashkise Roskovec per familjet qe kane mbetur te pastreha per shkak te investimit per interes publik dhe perjashtimit nga procesi i legalizimit.

Nenkryetari M. Goga sqaron se vendimi i marr nga ju ishte shitja e 3 apartamenteve per 3 familje qe ju i keni. Per z. Shkelqim Begaj nuk do te zbatohet shitja e prones, pra do shfuqizohet vendimi per kete familje pasi me date 26.06.2020 perfaqesuesi i Sh. Begaj bazuar ne kerkesen e tij dhe aktmarrveshje, ka derdhur ne llogari te bashkise kontributin financiar per projektin "Ndertim memoriali ne Roskovec". Familja e F. Kasemaj ka shprehur dakortesine per blerjen e apartamentit sipas cmimit perkates ne zbatim te programit "Banese me kosto te ulet". Per familjen e N. Driza ne rast refuzimi te blerjes se prones, propozojme si alternative strehimi te perkohshem huaperdorjen e prones publike ne pronesi te Bashkise Roskovec. Hidhet ne votim projekti "Per disa ndryshime ne Vkb Nr.27 date 27.04.2020 dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro (3/5) vota pro sipas materjalit te paraqitur nga zyra perkatese per keto 3 familje.

18. Diskutime dhe komente te qytetareve.

Nuk ka diskutime nga qytetaret e pranishem. Leksi-e disata here qe une kerkoje te na vij nje perfaqesues te Oshee-se per problemin e energjise elektrike. Kerkon pergjigje nga Kryetarja per policat e trafikut, problemin e shkalleve tek Alush Grepcka. Nenkryetari sqaron se projekti eshte ne ditet e fundit dhe do zbatohen te gjitha sinjalistikat e rugeve. Leksi-problem cilesia e trotuareve, jane bere punime pa cilesi. Nenkryetari-tek Alush Grepcka do te behen edhe ato. Komisioni i Barazise Gjinore ka nje kerkese per bashkine, kerkon informacion mbi numrin e grave kryefamiljare qe drejtojne nje biznes. Kerkojme pergjigje nga bashkia mbledhjen tjeter. Kryetari i Keshillit falenderon edhe perfaqesuesit e projektit "Bashki te Forta" per asistencen e tyre mbledhjen e sotme, e cila u transmetua live. Mbyllet mbledhja e sotme.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Kadri Hyska

